



## Buletini informativ # 7 – janar-shkurt 2013

---

- Seanca e 19<sup>të</sup> e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut
- Shkelja e të drejtave të njeriut sa i përket të drejtës për zgjidhje efektive
- Vendimi pasues në lëndët e *Vidovdanit*
- Gratë të angazhuara në sundimin e ligjit në Kosovë
- Raporti vjetor 2013
- Fushata informuese: Prezantim për studentet e masterit – Transmetim televiziv

### Seanca e 19<sup>të</sup> e PShDNj-së

[Seanca](#) e 19<sup>të</sup> e rregullt e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli) është mbajtur në Prishtinë nga data 3 deri më 5 shkurt 2014. Paneli ka shqyrtuar shtatë ankesa dhe ka marrë vendime në gjashtë lëndë. Në një lëndë, Paneli ka konstatuar se EULEX-i në Kosovë ka shkelur të drejtën e ankuesit për zgjidhje efektive. Paneli gjithashtu ka rishikuar zbatimin e rekomandimeve të tij nga ana e EULEX-it në Kosovë në lëndët e Vidvodanit (*A,B,C&D kundër EULEX-it*). Gjatë seancës janë shpallur tre lëndë të papranueshme, ndërsa një lëndë është hequr nga lista.

### E drejta për zgjidhje efektiv

Paneli ka konstatuar se EULEX-i në Kosovë ka shkelur të drejtën e ankuseses për një zgjidhje efektive në lëndën [Zahiti kundër EULEX-it](#). Ankuesja ka deklaruar se ishte sulmuar dhe lënduar nga një zyrtar policor i EULEX-it dhe si rezultat nuk ishte në gjendje të punonte për disa muaj.

Paneli ka konstatuar se EULEX-i si mision i sundimit të ligjit me një mandat të kufizuar ekzekutiv pritet të ofroj zgjidhje efektive në lidhje me pretendimet e argumentuara në lidhje me veprimet e anëtarit të stafit të tij. Në këtë lëndë, Paneli ka konstatuar se EULEX-i që në fillim ka mohuar çfarëdo përgjegjësie në këtë çështje dhe nuk ka arritur të ofroj një mjet procedural, përmes së cilës ankuesja ka mundur ta çonte më tutje kërkesën e saj. Paneli ka ftuar shefin e misionit për t'iu qasur gabimeve përmes një sërë rekomandimesh për korrigjim.

### Vendimi pasues në lëndët e *Vidovdanit*

Në një [vendim pasues](#) në lëndët *A,B,C&D kundër EULEX-it*, Paneli ka konstatuar se shefi i misionit të EULEX-it në thelb ka zbatuar rekomandimet e Panelit. Këto lëndë kanë të bëjnë me katër ankues, të cilët kanë pohuar se iu ishin nënshtruar sulmeve nga palë private të pidentifikuara, veprave që ndër të tjera përfshijnë hedhjen e gurë dhe koktej molotovit në adoleshentë serbë që udhëtonin me autobusë gjatë festimeve të *Vidovdanit* të datë 28 qershorit 2012. Një tjetër ankuesi ka pohuar se

ishite sulmuar nga policia e Kosovës në të njëjtin rast. Paneli ka konstatuar se pamjaftueshmëria e mjeteve të caktuara nga EULEX-it për operacionin e sigurisë në atë ditë kishte kontribuar që ankuesve t'i mohohet gjësimi i plotë dhe efektiv i së drejtës së tyre në respektimin e jetës private, lirisë së tyre për tubim si dhe të drejtën e tyre në ushtrimin e fesë së tyre në mënyrë të sigurt dhe pa pengesa të panevojshme. Për më tepër, Paneli ka konstatuar se EULEX-i nuk ka treguar se kishte kryer ndonjë hetim të plotë dhe të përshtatshëm lidhur me shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut. Paneli ka paraqitur një varg rekomandimesh korrigjuese EULEX-it, në mënyrë që t'iu qaset gabimeve të identifikuara.

Paneli, në vendimin e tij, ka përgëzuar shefin e misionit për veprimin e tij në zbatimin e rekomandimeve në lidhje me planifikimin operativ të policisë së EULEX-it gjatë festimeve të ardhshme të Vidovdanit më 28 qershor 2013. Këto veprime kanë përfshirë kryerjen e vlerësimit të rrezikut, zhvillimin e planeve të hollësishme operative, bashkërendimin e ngushtë ndërmjet të gjithë palëve të përfshira në operacionin e sigurisë, si dhe lëshimin e udhëzimeve të qarta për policinë e EULEX-it për çështjet e rëndësishme të të drejtave të njeriut, të cilat mund të dalin. Po ashtu Paneli ka vënë në dukje se shefi i misionit ka marrë një varg hapash për të siguruar që rastet e pohuara të shkeljeve të të drejtave të njeriut të hetohen.

### **Vendimet e papranueshmërisë dhe heqja e një lënde**

[Një prej lëndëve](#), e cila është shpallur e papranueshme nga Paneli në seancën e fundit ka të bëjë me procedurat e pronësisë që tani për tani janë në vazhdim e sipër pranë një gjykate të Kosovës. Paneli ka konstatuar se bazuar në konceptin e tij të llogaridhënies, Paneli nuk mund të shqyrtojë procedurat gjyqësore që janë para gjykatave të Kosovës. Si në rastet e mëparshme të ngjashme, Paneli ka konstatuar që fakti se gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues të çfarëdo gjykate nuk do të thotë se ia humb asaj gjykate karakterin e të qenit pjesë përbërëse e sistemit juridik të Kosovës.

I njëjti arsyetim është marrë në një [vendim tjetër](#) të papranueshmërinë që lidhet me një kontest pronësor. Një [lëndë tjetër](#) që kishte të bënte me procedurat e privatizimit të një ndërmarrje në pronësi publike, si dhe kërkesave që lidhen me një pension invalidor janë shpallur të papranueshme për të njëjtat arsye. Paneli ka marrë një vendim në një rast tjetër për të [hequr një lëndë](#) nga lista e ankesave, pasi që përfaqësuesi i ankuesit nuk iu ishte përgjigjur kërkesave të vazhdueshme të Panelit për dhënien e informatave. Prandaj, Paneli ka nxjerr në përfundim se ankuesi kishte humbur interesimin për vazhdimin e ankesës së tij.



Znj. [Magda Mierzewska](#) dhe znj. [Katja Dominik](#) janë paraqitur në një varg intervistash kohëve të fundit në “Gratë në sundimin e ligjit”, në faqen e internetit të EULEX-it. Znj. Mierzewska, Kryesuese e Panelit është juriste në Sekretarinë e Gjykatës Evropiane të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut në Strasburg, ndërsa znj. Domenik, anëtare në Panel nga EULEX-i është gjykatëse ndërkombëtare në gjykatën themelore në Mitrovicë.

### **Raporti vjetor i vitit 2013**

Në shkurt të vitit 2014, Paneli ka nxjerrë raportin e tij të katërt vjetor, që mbulon aktivitetet e tij gjatë gjithë vitit 2013. Raporti vjetor shtjellon lëndët dhe jurisprudencën e Paneli, duke i përmendur hollësisht shkeljet e të drejtave të njeriut të cilat janë vendosur, si dhe duke u përqendruar në aspektet e ndryshme të pranueshmërisë.

Raporti vjetor gjithashtu ofron statistika dhe jep një pasqyrë të aktiviteteve të fushatës informuese të Panelit dhe çështje të tjera të rëndësishme, duke përfshirë çështje administrative dhe buxhetore. Për më tepër, raporti ofron një përmbledhje të komentit gjithëpërfshirës ndërkombëtar juridik, që Paneli e ka marrë në vitin 2013. Në kuadër të rishikimit të vazhdueshëm strategjik të EULEX-it dhe ristrukturimit të ardhshëm të EULEX-it, Paneli ka paraqitur një varg rekomandimesh se si të ruhet dhe përmirësohet efikasiteti i mekanizmave llogaridhënës të të drejtave të njeriut qoftë në EULEX apo në misione të ngjashme të BE-së në të ardhmen. Ky raport është në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe në [faqen e internetit të Panelit](#).

### Prezantimi i PShDNj-së për studentë lidhur me programin e masterit për të drejtat e njeriut


Më 14 janar 2014, mbi 100 studentë nga programi evropian i masterit për të drejtat e njeriut dhe demokratizim (E.MA) të Venedikut si dhe nga shkalla e masterit në shkencat shoqërore në të drejtat e njeriut të universitetit të Vjenës kanë marrë pjesë në një varg prezantimesh të organizuara nga ana e zyrës për shtyp dhe informim publik i EULEX-it.

Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut iu është ofruar mundësia që ta bëjë një prezantim para studentëve lidhur me mandatin, punën dhe procedurat e veta. Pas këtij prezantimi ka pasur pyetje dhe përgjigje lidhur me vendimet e Panelit, strukturën e tij, pavarësinë e tij, arritjet dhe ndikimin e tij në të drejtat e njeriut brenda EULEX-it. Prezantimi kishte të bënte me Panelin si model i mundshëm për organizatat ndërkombëtare me rol ekzekutiv në të ardhmen sa i përket llogaridhënies ndaj shkeljeve të pretenduara të të drejtave të njeriut.



Eldita Taranai (ZShIP) dhe Florian Razesberger (zyrtar ligjor në PShDNJ) gjatë diskutimit me studentë në zyrat qendrore të policisë së EULEX-it

### Statistikat e lëndëve - shkurt 2014



### Paneli në televizion

Që nga shkurti 2014, Paneli me mbështetjen e EULEX-it transmeton një spot televiziv në televizionet e Kosovës lidhur me procedurën e nevojshme për paraqitjen e një ankese pranë Panelit.



## PARASHTRIMI I ANKESAVE

(Rregullat 25 dhe 26 të rregullores së punës të PShDNj-së)

### Kush?

Çdo person i cili nuk punon për misionin e EULEX-it në Kosovë, i cili ankohet se ka qenë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e misionit të EULEX-it në Kosovë gjatë zbatimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Ankuesi (personi që e bën ankesën) mund të përfaqësohet nga ndonjë avokat ose përfaqësues tjetër sipas dëshirës së tij ose saj. Në këtë rast duhet të plotësohet autorizimi.

### Çka?

Paneli do t'i shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me këto shkelje të dyshuara, të cilat kanë ndodhur në Kosovë pas datës 9 dhjetor 2008. Shkelja duhet të jetë shkaktuar nga misioni i EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Paneli nuk do t'i shqyrtojë procedurat gjyqësore të kryera nga gjykatat në Kosovë.

### Kur?

Ankesa duhet t'i parashtrohet Panelit brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së dyshuar.

### Si?

Ankesa duhet të parashtrohet me shkrim. Ankesa nuk mund të bëhet me telefon. Ankuesi mund ta përdorë gjuhën angleze, shqipe ose serbe. Normalisht, ankesa duhet të plotësohet në formularin përkatës dhe të shoqërohet me dokumente dhe vendime përkatëse (nëse ka), sipas udhëzimeve në formular.

Nëse ankesa paraqitet me anë të letrës, në të duhet të përcaktohet, të paktën në formë të përmbledhur, lënda e ankesës në mënyrë që ajo të shqyrtohet më tej.

### Ku?

Ankesa mund të parashtrohet në

**Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut - Sekretariati**

Rr. Rrustem Statovci; nr. 29 – 10000 Prishtinë – Kosovë

Tel: +381 (0) 38 78 2125

Ankesa gjithashtu mund të parashtrohet përmes postës elektronike në: [office@hrrp.eu](mailto:office@hrrp.eu)

[www.hrrp.eu](http://www.hrrp.eu)

### Plotësimi i formularit për ankesë

Ankesa duhet të shkruhet qartë dhe lexueshëm, dhe mundësisht të jetë e shtypur me kompjuter.

Formulari duhet t'i përfshijë të gjitha hollësitë kontaktuese të ankuesit.

Nëse ankesa përmban fakte të dokumentuara, duhet të paraqiten kopjet e lexueshme. **Mos i dërgoni dokumentet origjinale.**

Dokumentet duhet të renditen sipas datës dhe të shënohen me numra rendor të njëpasnjëshëm dhe me një përshkrim të shkurtë (p.sh. letër, urdhër, vendim, ankesë, etj.).

Ankesës i caktohet numri i dosjes. Numri i dosjes duhet të përmendet në të gjitha korrespondencat vijuese. Nëse ankuesi tashmë e ka një ankesë, e cila është duke u shqyrtuar nga Paneli, ai/ajo duhet ta informojë Panelin lidhur me numrin e dosjes së mëparshme. Nëse ankuesi për arsye të ndryshme nuk dëshiron që identiteti i tij/saj të bëhet publik, ai/ajo duhet ta plotësojë pjesën përkatëse në formularin e ankesës.